



UNIVERSITETI I TETOVËS  
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

FAKULTETI EKONOMIK

DEPARTAMENTI: FINANCA

## CIKLI I TRETË I STUDIMEVE – STUDIMET E DOKTORATURËS

Në bazë të vendimit *Nr.14-932/7* të datës 20.12.2023 të Këshillit mësimor shkencor të Fakultetit ekonomik, për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës, komisioni në përbërje: **1. Prof.Dr. Raman Ismaili - Kryetar, 2. Prof .Dr. Etem Iseni - anëtar, 3. Prof. Dr. Merale Fetahi-Vehapi - anëtar, 4. Prof. Dr. Afrim Atili - anëtar, 5. Prof. Dr. Besa Xhaferi - anëtar**, pasi vlerësoi disertacionin e doktoraturës me titull:“ *Sistemi financiar si faktor i rritjes ekonomike*”, të kandidatës **MBA Gonxhe Osmani**, paraqet këtë:

### RAPORT

#### Për vlerësim të disertacionit të doktoraturës „*Sistemi financiar si faktor i rritjes ekonomike*“ të kandidatës **MBA Gonxhe Osmani**

Këshilli mësimor shkencorë i Fakultetit ekonomik pranë Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e saj të rregullt, na përcaktoi si anëtarë të komisionit për vlerësim të punimit të doktoraturës të kandidatës MBA Gonxhe Osmani me temë: „*Sistemi financiar si faktor i rritjes ekonomike*”, Punimi u shqyrtua me vëmendje të thellë, me qëllim që përpara këshillit mësimor shkencorë të fakultetit të dorëzojmë këtë raport.

### 1. LËNDA E HULUMTIMIT

Ndikimi i sistemit financiar në rritjen ekonomike është një problematikë e studiuar nga ana e shumë studiuesve në kohën e fundit, sidomos pas krizës financiare. Në të kaluarën shumë autorë mendonin se kjo është një çështje mjaft e thjeshtë dhe e nënkuptuar dhe të cilës

akademikët nuk duhet ti kushtojnë rëndësi për studim. Mirëpo, kriza financiare globale në vitin 2008, bëri që rëndësia e kësaj problematike të rritej edhe më shumë. Më së fundmi sidomos me paraqitjen e pandemisë patëm rastin të shohim se si sistemi financiar, me anë të bankave si pjesë më e rëndësishme e tyre u munduan që të mbështesin bizneset e prekura më shumë dhe me këtë poashtu të ndihmojnë edhe ekonominë e vendit.

Lidhshmëria ndërmjet sistemit financiar dhe rritjes ekonomike është shtjelluar në prizma të ndryshme nga studiues të ndryshëm, disa prej tyre kanë studiuar faktin se sistemi financiar ka ndikim mbi rritjen ekonomike apo rritja ekonomike ka ndikim mbi sistemin financiar, pastaj është studiuar edhe ajo se lidhshmëria ndërmjet këtyre faktorëve është afatshkurte apo afatgjate, si ndikon sistemi financiar në rritjen ekonomike nëpërmjet cilave parametra, a është sistemi financiar faktor stimulues apo kufizues në rritjen ekonomike etj.

Sistemi financiar ka rol crucial dhe mjaft të rëndësishëm në rritjen ekonomike të vendit me atë që bën bartjen e fondeve të lira financiare prej atyre që kanë tepriçë të mjeteve financiare qofshin ato amvisëri, biznese apo edhe vetë qeveria, te ata të cilët kanë mungesë të mjeteve. Ky është një sistem kompleks i përbërë nga shumë pjesë me anë të së cilave mund të ndikojë në ekonominë e një vendi. Mirëpo, këto pjesë mund të përmbliohen në dy grupe kryesore edhe atë në: banka dhe institucione financiare jobankare. Sistemi financiar me ndihmën e përbërësve të tij arrijnë që ti kryejë edhe funksionet kryesore të tijë edhe atë funksionin e kursimit, funksionin e likuiditetit, pagesor, të politikëbërjes, pasurisë, funksionin kreditues dhe atë të rrezikut.

Në mungesë të tregjeve të zhvilluara të kapitalit sistemin financiar në Maqedoni më së shumëti e përbëjnë bankat. Prandaj, mund të themi se stabiliteti i sistemit financiar në vend mvaret më së shumëti nga stabiliteti i bankave. Në bazë të teorive ekzistuese bankat me anë të kredive që japin rrisin ofertën monetare e cila ndikon në uljen e normave të interesit, rritjen e investimeve, rritjen e kërkesës agregate dhe si rezultat i kësaj kemi rritje të Prodhimit Bruto Vendor.

Pasi Maqedonia ende është një ndër vendet me nivel të ulët të rritjes ekonomike, vendosëm që ky disertacion doktrate të shqyrtojë mënyrat se si nëpërmjet të zhvillimit të sistemit financiar mund të ndikohet në zhvillimin ekonomik të vendit.

## 2 KORNIZA METODOLOGJIKE

Studimi i realizuar paraqet një studim të hollësishëm dhe të detajuar që është bërë në bazë të hulumtimit të një literature të gjerë të autorëve të vendit dhe të huaj, duke shfrytëzuar të dhëna kuantitative për periudhë më të gjatë kohore. Kjo me qëllim që të nxiren përfundime sa më të drejta, më të sakta dhe më gjithëpërfshirëse për sa i përket studimit të problematikës së hulumtuar në këtë punim.

Të dhënat e shfrytëzuara për realizim të studimit janë të dhëna sekondare, të cilat kryesisht meren nga raportet e publikuara nga Banka Qëndrore, Enti shtetëror statistikor dhe Berza e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Varësisht prej asaj se sa është mundur të sigurohen të dhëna për hipotezat e caktuara aq është edhe gjatësia e periudhës së analizuar.

Për sa i përket hipotezës së parë e cila ka të bëjë me ndikimin e bankave mbi sistemin financiar, periudha e analizuar është periudhë gjatëmbëdhjetë vjeçare edhe atë nga viti 2006 deri në vitin 2021. Të dhënat që janë përdorur janë kuartale, prandaj në punim përfshihen gjithsej 64 observime.

Për sqarimin e hipotezës së dytë që ka të bëjë me ndikimin e institucioneve financiare jobankare mbi rritjen ekonomike është shqyrtuar periudha tetë vjeçare edhe atë nga viti 2014 deri në vitin 2021. Të dhënat e shqyrtuara edhe këtu janë kuartale, prandaj në punim janë përfshirë gjithsej 32 observime.

Periudha e analizuar për sqarimin e hipotezës së tretë është një periudhë tetëmbëdhjetë vjeçare në të cilën është përfshirë periudha nga viti 2004 deri në vitin 2021. Pasi të dhënat janë kuartale këtu kemi gjithsej 72 observime.

Metodat hulumtuese që do të shfrytëzohen në këtë punim janë metoda përshkruese, krahasuese, metoda e analizës si dhe metoda ekonometrike duke zbatuar regresionin e shumëfishtë.

Kapitulli në vijim është kryesisht teorik në të cilën vin në shprehje zbatimi i metodës përshkruese duke shqyrtuar literaturë të marë për bazë nga autorë të ndryshëm dhe në të cilën bëhet përshkrimi teorik i rritjes ekonomike, sistemit financiar, përbërësve të tij, modelet, funksionet e tij etj.

Punimi është organizuar në katër pjesë, si vijon:

Në pjesën e parë të punimit përfshihet: Hyrja, lënda e hulumtimit, korniza metodologjike, hipoteza hulumtuese, rezultatet e pritshme dhe organizimi i punimit;

Në pjesën e dytë të punimit, kandidatja fokusohet në kornizën teorike, kuptimi mbi rritjen ekonomike, definimi i sistemit financiar, funksionet e sistemit financiar, modelet e sistemit financiar, tregjet financiare, ndërmjetësit financiarë, strukturat financiare, treguesit për matje të zhvillimit të sistemit financiar si dhe efikasiteti i ndërmjetësit financiar në rritjen dhe zhvillimin ekonomik;

Pjesa e tretë të punimit: Sistemi financiar dhe rritja ekonomike në Maqedoninë e Veriut, ngërthen në vet: ecurinë e rritjes ekonomike në Maqedoni, analizë e strukturës së sistemit financiar në RMV, struktura organizacionale e bankave në RMV, sektori bankar në RMV, shtëpia e kliringut – KIBSI, fondi për sigurim të depozitave, bursa e RMV-së për tregëtimin e letrave me vlerë si dhe analizë krahasimore e sistemit financiar në Maqedoni me sistemin financiar të Shqipërisë dhe Kosovës;

Ndërsa, në kapitullin e katër të punimit përfshihen metodologjisë hulumtuese dhe të analizimit të të dhënave kemi përdorur model ekonometrik edhe atë regresionin e shumëfishtë si metodë për matjen e lidhshmërisë ndërmjet të variablave të pavarura me variablën e varur që në këtë rast është GDP. Modeli është zbatuar për matje dhe vërtetim në veçanti të të tre hipotezave bazë të caktuara në punim. Shqyrtimi i këtyre të dhënave është realizuar duke përdorur program statistikor edhe atë është përdorur programi SPSS Statistics 26. Në pjesën të punimit, fillimisht është testuar rëndësia e modelit të krijuar ekonometrik bazuar në rezultatet e fituara për sa u përket treguesve të fituar si  $R^2$  dhe  $R^2$  të përshtatur. Ndërsa, pastaj është bërë edhe interpretimi i rezultateve bazuar në modelet e fituara duke sqaruar në veçanti koeficientët e fituar për çdo variablë të pavarur të përdorur në model si dhe shqyrtimi i signifikancës së tyre për modelin e realizuar.

Në fund të punimit prej analizës së të dhënave dhe rezultateve të fituara janë nxjerë përfundimet dhe rekomandimet nga ky punim, si dhe pritshmëritë për studime të më tutjeshme.

### 3. HIPOTEZA HULUMTUESE

Qëllimi i këtij punimi është që të përshkruajë, analizojë, krahasojë dhe të matë në mënyrë empirike ndikimin e sistemit financiar mbi rritjen ekonomike në Maqedoni.

Duke marrë parasysh se sistemin financiar të ne e përbëjnë: bankat, institucionet financiare jobankare dhe tregjet financiare edhe hipotezat janë bazuar në këto tre pjesë kryesore të sistemit financiar. Ku për të matur ndikimin e sistemit financiar mbi rritjen ekonomike, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, jemi bazuar në tre hipoteza kryesore edhe atë:

$H_1$  – Bankat kanë ndikim pozitiv mbi rritjen ekonomike

$H_2$  – Institucionet financiare jobankare kanë ndikim pozitiv mbi rritjen ekonomike

$H_3$  – Tregjet financiare kanë ndikim pozitiv mbi rritjen ekonomike

Për shpjegimin e hipotezës së parë janë marrë variablat e pavarura të cilat jemi munduar të jenë më gjithëpërfshirëse duke sqaruar aspekte të ndryshme të zhvillimit të bankave edhe atë nga aspekti i madhësisë ose shërbimeve të ofruara nga ana e bankave, nga aspekti i efikasitetit të bankave si dhe nga aspekti i profitabilitetit të tyre. Si variabla të pavarura kemi marrë raportin aktivë të bankave me GDP me anë të së cilës matet madhësia e pjesëmarrjes bankave në ofrimin e shërbimeve financiare, kapitalin adekuat të bankave dhe kreditë e këqija në raport me kreditë totale me anë të së cilave matet efikasiteti i bankave, si dhe ROAA dhe ROAE me anë të së cilave matet profitabiliteti i bankave. Ndërsa, si variabël e mvarur është marrë GDP.

Sqarimi i hipotezës së dytë është bërë duke analiuar aktivën e institucioneve financiare jobankare edhe atë janë marrë parasysh shoqëritë e sigurimit, fondi pensional, fondet investive, shoqëritë e lizingut, shoqëritë për udhëheqje të fondit pensional dhe shoqëritë për udhëheqje të shoqërive të lizingut.

Edhe pse e dimë se tregjet financiare në vendin tonë janë të pa zhvilluara, për të përmbushur qëllimin e studimit dhe për të analizuar sistemin financiar në tërësi është përfshirë edhe kjo pjesë në studim ku hipoteza e tretë ka të bëjë me tregjet financiare. Pritshmëritë e punimit janë që të ketë lidhshmëri pozitive ndërmjet të tregjeve financiare dhe rritjes ekonomike.

Me anë të hipotezave bazë të caktura si dhe me testimin e tyre ne arrijmë në përmbushjen e qëllimit kryesor të punimit.

#### **4 ORGANIZIMI I PUNIMIT**

Studimi fillimisht niset me përshkrimin teorik për sistemin financiar dhe rritjen ekonomike bazuar në literaturë të shqyrtuar nga autorë të ndryshëm të huaj dhe të vendit. Këtu analizohet pjesa teorike për atë se çka paraqet rritja ekonomike dhe si llogaritet ajo në bazë të metodës së të ardhurave dhe si llogaritet në bazë të metodës së shpenzimeve, si dhe analizimi i faktorëve të cilët ndikojnë në zhvillimin ekonomik të një vendi.

Pastaj vazhdohet me analizimin në hollësi të asaj se çka paraqet sistemi financiar. Në këtë pjesë bëhet analizimi i përbërjes strukturore të sistemit financiar duke shqyrtuar mënyrën e funksionimit adekuat të këtij sistemi. Sqarimi i lëvizjes së mjeteve financiare nga huadhënësit të cilët mund të jenë amvisëritë, bizneset, qeveria apo investitorët, të cilët kanë tepricë të mjeteve financiare dhe të cilat i investojnë në tregun financiar qoftë në mënyrë direkte me anë të tregjeve financiare ose në mënyrë indirekte me anë të ndërmjetësve financiar.

Në punim sqarohet edhe stabiliteti financiar i cili arrihet duke lehtësuar pabarazitë financiare që mund të paraqiten te pjesëmarrësit e sistemit financiar si rezultat i faktorëve endogjen ose si rezultat i faktorëve të jashtëm të paparashikuar. Kjo arrihet me anë të kontrollimi të nivelit të huadhënies dhe huamarrjes, kontrollimin e nivelit të konsumit dhe të investimit etj.

Gjithashtu bëhet edhe shqyrtimi i funksioneve kryesore të sistemit financiar përfshirë këtu: funksionin e kursimit, likuiditetit, pagesor, politikëbërjes, pasurisë, kreditues dhe funksionin e riskut.

Sqarimin e modeleve të sistemit financiar siç janë: tregjet financiare dhe ndërmjetësit financiar. Varësisht prej vendeve se sa kanë të zhvilluar sistemin financiar të tregjeve ose të bankave vende të ndryshme zgjedhin modele të ndryshme të sistemit financiar.

Në pjesën e shqyrtimit të treguesve të zhvillimit të sistemit financiar jemi bazuar në kriteret e ndarjes në bazë të Bankës Botërore ku këto tregues ndahen në katër grupe kryesore edhe atë: madhësia e sistemit financiar, efikasiteti, stabiliteti dhe qasja. Me anë të madhësisë së

sistemit financiar bëhet matja e përmasave të institucioneve dhe tregjeve financiare, Ky tregues matet me anë të raportit të aktivës likuide të tyre dhe GDP. Efikasitet financiar ka të bëjë me matjen e nivelit të aftësisë së tregjeve dhe institucioneve financiare për të menaxhuar drejtë të ardhurat dhe shpenzimet e tyre. Efikasiteti financiar mund të matet me anë të shqyrtimit të treguesve të profitabilitetit të bankave më shumë të përdorur janë ROI dhe ROA, ku ROI paraqet nivelin e kthimit nga investimi, ndërsa ROA paraqet nivelin e kthimit nga aktiva. Shqyrtimi i stabilitetit financiar bëhet me anë të treguesit të likuiditetit, nivelit të kapitalit adekuat, kualitetit të aktivës etj. Në fund kemi matjen e nivelit të zhvillimit të sistemit financiar me anë të qasjes në institucione financiare qoftë në banka apo në tregjet financiare. Kjo mënyrë e llogaritjes së zhvillimit të sistemit financiar mer parasysh numrin e transaksioneve të realizuara në banka, numri i shitjeve ose blerjeve të letrave me vlerë e kështu me rradhë, pra me fjale tjera mat atë se sa shumë përdorin shërbime financiare pjesëmarrësit e sistemit financiar për realizim të aktiviteteve financiare nga ana e popullatës në një vend.

Në fund të kornizës teorike kemi shqyrtimin e asaj se si ndikon efikasiteti i ndërmjetësimit financiar mbi rritjen ekonomike, duke u bazuar në teori të njohura për rritjen ekonomike të cilat kanë patur ndikim të lartë në analizimin e ndikimit të sistemit financiar mbi rritjen ekonomike.

Pjesa në vazhdim e emërtuar si “Sistemi financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut” është më shumë pjesë praktike që sqaron me anë të të dhënave konkrete elemente të sqaruara teoritikisht në pjesën e parë. Kjo është pjesa në të cilën bëhet një përshkrim i detajuar i sistemit financiar në vendin tonë bazuar në të dhëna kuantitative të analizuar.

Fillimisht në këtë pjesë analizohet rritja ekonomike në vendin tonë për periudhë njëzet e një vjeçare edhe atë prej vitit 2001 deri në vitin 2021. Në shqyrtimin e GDP për këtë periudhë mund të shohim se rënie të madhe ka patur në fillim të periudhës së analizuar edhe atë në vitin 2001 shkaku i konfliktit politik dhe në fund të vitit 2020 shkaku i paraqitjes së pandemisë si rezultat i paraqitjes së virusit Covid 19, ku gjatë këtij viti patën rënie edhe shumë vende tjera në botë jo vetëm te ne.

Pas analizimit të rritjes ekonomike kemi analizimin e sistemit financiar te ne, ku në bazë të raportit të Bankës Qëndrore për vitin 2020 80.8% të sistemit financiar e përbëjnë bankat, ndërsa pjesën e ngelur prej 19.2% e përbëjnë institucionet financiare jobankare në të cilat

përfshihen fondet pensionale, fondet investive, fondi shëndetësor, shoqëritë e sigurimit, shoqëritë e lizingut si dhe shoqëritë për udhëheqje të fondeve pensionale dhe për udhëheqje të shoqërive të lizingut. Në krahasim me vitin 2019 pjesëmarrja e bankave në sistemin financiar ka patur një rënie të lehtë nga 81.7% në 80.8%, ndërsa pjesëmarrja e institucioneve financiare jobankare ka patur trend rritës nga 18.8 në 19.2. Ndërsa, në rastet kur bëhet shqyrtimi i pjesëmarrjes së këtyre institucioneve në GDP e vendit kemi rritje të pjesëmarrjes së bankave në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019. Kjo rritje për bankat është nga 80.1% që është në vitin 2019 në 88.5% në vitin 2020. Ndërsa, te institucionet financiare jobankare gjithashtu verëhet një rritje, mirëpo kjo rritje është më e ulët se rritja te bankat. Institucionet financiare treguan rritje nga 17.9% në vitin 2019 në 21% në vitin 2020.

Në këtë pjesë rëndësi i kushtohet analizimit në hollësi i institucioneve financiare. Fillimisht bëhet sqarimi mbi Bankën Qëndrore si organ më i rëndësishëm financiar i cili si qëllim kryesor ka ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar. Këtu sqarohet struktura organizative e bankës, funksionet e saj, instrumentet me anë të së cilave kjo bankë realizon qëllimet e saja etj. Si funksione kryesore të cilat i ka kjo bankë mund të përmendimin përgatitjen dhe zbatimin e politikës monetare, përcaktimin e kursit të këmbimit, politikën e kursit devizor, drejtimin e rezervave devizore, përgatitjen e bilancit pagesor, kujdeset mbi efikasitetin e sistemeve pagesore dhe shumë funksione të tjera.

Pasi bankat përbëjnë pjesë më të madhe të sistemit financiar në vendin tonë ky punim i kushton rëndësi të veçantë pjesës për bankat. Ketu bëhet analizimi i bankave komerciale duke bërë fillimisht një përshkrim teorik mbi historikun e paraqitjes së bankave te ne duke filluar nga zhvillimi i bankave para Luftës së parë Botërore, zhvillimi i bankave pas Luftës së parë Botërore, zhvillimi i bankave pas pavarësisht dhe sqarimi i sistemit bankar sot.

Sistemi bankar te ne sot përbëhet nga 14 banka dhe 2 kursimore. Kemi disa lloje të bankave edhe atë banka të mëdha, banka të vogëla dhe banka të mesme. Kjo ndarje është në bazë të aktivës së bankave.

Në pika të shkurtëra bëhet edhe sqarimi për institucionet financiare si kursimoret, KIBS, Fondi për sigurim të depozitave si dhe sqarime mbi berzën e Republikës së Maqedonisë Veriore.



Në fund të kësaj pjese kemi sqarim edhe të sistemit financiar të vendeve fqinje si Shqipëria dhe Kosova dhe krahasimin e sistemeve financiare të këtyre vendeve me sistemin financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Pjesa e fundit “Metodologjia hulumtuese dhe të dhënat në punimin empirik” paraqet pjesën empirike dhe pjesën më të rëndësishme në të cilën bëhet testimi i hipotezave të caktuara paraprakisht. Ky kapitull përbëhet nga pesë pjesë kryesore edhe atë: analizë e rezultateve të punimeve të më parshme ku përshkruhen punime të shqyrtuara nga autorë të huaj dhe të vendit në lidhje me hipotezat bazë të studimit, që do të thotë se analizohen punime për sa i përket lidhshmërisë ndërmjet bankave dhe rritjes ekonomike, lidhshmërisë së instituioneve financiare jobankare dhe rritjes ekonomike si dhe lidhshmërisë së tregjeve financiare dhe rritjes ekonomike. Pastaj bëhet specifikimi i modelit ekonometrik.

Pasi që statistika dhe matjet ekonometrike janë bë një pjesë mjaftë e rëndësishme e jetës tonë në këtë pjesë sqarojmë atë se çka paraqet statistika si dhe rëndësinë e saj, pastaj sqarimin e regresionit. Ku regresioni paraqet një model me anë të së cilës matet lidhshmëria ndërmjet një variable të pavarur me një ose më shumë variabla të pavarura. Në fund kemi prezantimin dhe analizën e rezultateve ku bëhet sqarimi në veçanti i çdo variable që është përdorur në model, përpilimin e tre modeleve kryesore të regresionit të shumëfishtë për të tre hipotezat bazë: bankat kanë ndikim pozitiv mbi rritjen ekonomike, institucionet financiare jobankare kanë ndikim pozitiv mbi rritjen ekonomike dhe në fund nxjerrjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve bazuar në rezultatet e përfituara nga modeli ekonometrik.

## **5. REZULTATET E PUNIMIT**

Punimi “Sistemi financiar si faktor i rritjes ekonomike” pritet që të jetë një literaturë shtesë dhe e hollësishme për sa i përket studimeve mbi sistemin financiar në përgjithësi dhe të analizuar në veçanti për Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Nga studimet e shqyrtuara kemi pa se ka punime të cilat analizojnë në veçanti ndikimin e përbërësve të sistemit financiar edhe atë të bankave, instituioneve financiare dhe shumë pak punime edhe për tregjet financiare mbi rritjen ekonomike.

Ky punim për dallim prej punimeve ekzistuese është më gjithëpërfshirës dhe më i detajuar pasi analizon sistemin financiar në përgjithësi, për një periudhë më të gjatë kohore dhe duke shqyrtuar më shumë variabla në krahasim me studimet paraprake. Gjithashtu punimi përmban edhe pjesën krahasimore të sistemit financiar të ne me sistemin financiar në vendet fqinje si Shqipëria dhe Kosova.

## **VLERESIM DHE PROPOZIM**

Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës në bazë të vendimit *Nr.14-932/7* të datës 20.12.2023 nga Këshilli mësimor shkencor të Fakultetit Ekonomik në Universitetit të Tetovës dëshiron të njoftojë Këshillin Mësimorë Shkencorë me vlerësimin e tij për punimin e doktoraturës me temë "Sistemi Financiar si Faktor i Rritjes Ekonomike" të dorëzuar nga kandidatja MBA Gonxhe Osmani.

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, komisioni arriti në përfundimin se kandidatja posedon kualitetet e nevojshme për të realizuar studime kërkimore-shkencore në fushën e shkencave ekonomike. Punimi i dorëzuar nga kandidatja shërben si model i shkëlqyer që ilustron qasjen e duhur dhe metodologjinë për kërkimet doktorale.

Bazuar në karakteristikat dhe cilësitë e paraqitura në punimin e doktoraturës dhe në cilësitë e vërtetuara të kandidatës, Keshilliit mësimor shkencor me kënaqësi propozojmë:






**1. Miratimin e Raportit të punimit të doktoraturës me temën "Sistemi Financiar si Faktor i Rritjes Ekonomike" të dorëzuar nga kandidatja MBA. Gonxhe Osmani.**

**2. Lejimin e mbrojtjes së punimit të doktoraturës nga kandidatja.**

Për besimin tonë në cilësitë shkencore të kandidatës dhe kontributin e vlefshëm që ajo sjell në fushën e shkencave ekonomike, shpresojmë që Këshilli Mësimorë Shkencorë të miratojë këtë propozim dhe të japë mundësinë për zhvillimin e procesit të mbrojtjes së punimit të doktoraturës. i posedon kualitetet e nevojshme për të realizuar studime kërkimore-shkencore në

fushën e shkencave ekonomike, ndërsa ky punim paraqet shembullin se si duhet të jetë qasja e kandidatëve gjatë përpunimit të një punimi të doktoraturës.

**Antarë të komisionit:**

1. Prof. Dr. Raman Ismaili – Kryetar \_\_\_\_\_; 
2. Prof. Dr. Etem Iseni - anëtar \_\_\_\_\_; 
3. Prof. Dr. Merale Fetahi-Vehapi - anëtar \_\_\_\_\_; 
4. Prof. Dr. Afrim Alili - anëtar \_\_\_\_\_; 
5. Prof. Dr. Besa Xhaferi - anëtar Besa Xhaferi \_\_\_\_\_; 

Tetovë, Mars, 2024